

Sëmundjet seksualisht të transmetueshme më të zakonshme

(IST)

Klamidia
Gonorreja
Sifilisi
Herpesi gjenital

Hepatiti B
HIV / AIDS
Lythet gjenitale (HPV)



Të testohesh është guxim, përgjegjësi
dhe dashuri për veten!

Mos harro!

#SKATURPMEUTESTU!

Informohu. Testohu. Mbrohu

**Kujdesi nuk është turp
- është tërheqës.**

#SkaTurpMeUTestu #IST #Testohu
#ShëndetPërTëGjithë #StopStigmës
#MbrojtjaËshtëForcë #NdaloPërhapjen
#VetëdijePërIST #Kujdesiështëtërheqës

**Kujdesu për
Shëndetin Seksual dhe Riprodhues**



CFLI/FCIL
Canada Fund for Local Initiatives
Fonds canadien d'initiatives locales



Disclaimer

Kjo broshurë është përgatitur nga Aksioni për Nëna dhe Fëmijë (AMC) në kuadër të Projektit të Fondit të Kanadasë për Iniciativa Lokale (CFLI) "Reduktimi i transmetimit të IST-ve dhe përmirësimi i shëndetit seksual në Kosovë."

Përmbajtja e këtij materiali është përgjegjësi e AMC-së dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht qëndrimet e Qeverisë së Kanadasë.

Çfarë janë IST-të?



Infeksionet seksualisht të transmetueshme (IST) janë sëmundje që kalohen nga një person te tjetri përmes kontaktit seksual vaginal, oral ose anal.

Ato shkaktohen nga baktere, viruse ose parazitë dhe prekin si gratë, ashtu edhe burrat.



Sipas OBSH-së, mbi 1 milion njerëz infektohen çdo ditë me një IST. Shumica e njerëzve nuk janë të vetëdijshëm për infeksionin, sepse shpesh nuk kanë simptoma.



Nëse nuk trajtohen, këto infeksione mund të ndikojnë në shëndetin riprodhues, të shkaktojnë vështirësi në shtatzëni, infertilitet dhe rritje të rrezikut për infeksione të tjera.





Si përhapen IST-të?



Përmes marrëdhënieve seksuale
të pambrojtura (nëpërmjet spermës, gjakut
apo lëngjeve vaginale)

Nga nëna te foshnja gjatë shtatzënisë,
lindjes apo gjidhënies




Përmes përdorimit të përbashkët të
gjilpërave apo mjeteve të mprehta

Më rrallë, përmes transfuzionit
të gjakut të pa testuar




**IST-të NUK TRANSMETOHEN
PËRMES PËRQAFIMEVE,
NDARJES SË USHQIMIT
APO PËRDORIMIT TË NJËJTËS TUALET.**


Si të mbrohesh?



- Përdorni gjithmonë prezervativë
- Bëni testime rregullisht
- Vaksinohuni kundër HPV dhe Hepatitit B
- Mbani higjienë të mirë personale
- Bëni testime gjatë shtatzënisë

*Në shumë raste nuk ka asnjë simptomë.
Prandaj, testimi i rregullt është mënyra e vetme për ta ditur
me siguri nëse jeni të infektuar.*






Pse është i rëndësishëm testimi?

Testimi është i shpejtë,
i saktë dhe konfidencial.

Trajtimi i hershëm:
Parandalon komplikimet;

Mbron shëndetin tënd dhe të partnerit;
Ndhmon në ndalimin e përhapjes
së infeksioneve.

*Të testohesh nuk është turp
– është përgjegjësi dhe kujdes
për shëndetin tënd.*



*"Një test i thjeshtë mund të
të mbrojë ty dhe personin që do."*

*Fol hapur, informohu dhe merr
kontrollin mbi shëndetin tënd
seksual dhe riprodhues.*

A mund të shkaktojnë IST-të probleme te gratë?

PO.

Disa IST mund të përhapen në mitrën dhe tubat fallopiane të gruas, duke shkaktuar sëmundjen inflamatore të pelvisit (PID).

Infeksionet që nuk trajtohen mund të çojnë në infertilitet dhe shtatzëni jashtë mitre, të cilat mund të shkaktojnë komplikime serioze, përfshirë vdekjen e fetusit ose të nënës.

Disa IST, si HPV dhe Hepatiti B, lidhen gjithashtu me kancerin e qafës së mitrës dhe të mëlçisë.

IST-të mund të transmetohen nga nëna te foshnja gjatë shtatzënisë, lindjes ose gjdhënies nëse nuk trajtohen siç duhet.

Po nëse jam shtatzënë?


Nëse je shtatzënë dhe mendon se mund të kesh një IST, ose nëse ke simptoma, kontakto menjëherë mjekun tënd.

Shumica e IST-ve mund të trajtohen në mënyrë të sigurt gjatë shtatzënisë për të mbrojtur si ty ashtu edhe foshnjën tënde.

Testimi dhe trajtimi i hershëm ndihmojnë në parandalimin e problemeve serioze shëndetësore për të porsalindurin.



Simptomat më të zakonshme

Rrjedhje jo e zakonshme nga organet gjenital	Djegje ose dhimbje gjatë urinimit	Plagë, ulçera ose kruarje në zonën gjenitale
Dhimbje gjatë marrëdhënieve seksuale		Dhimbje në pjesën e poshtme të barkut (te gratë)

Ku mund të këshilloheni dhe testoheni në Kosovë?

Qendrat Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF)

Qendrat Rajonale të Shëndetit Publik
(Ferizaj, Mitrovicë, Pejë, Prizren, Gjiilan, Gjakovë)

Spitalet Rajonale – Repartet e Gjinekologjisë

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK)
– Departamenti i Mikrobiologjisë, Prishtinë

QKUK – Klinika Gjinekologjike Obstetrike,
Klinika e Dermatovenerologjisë dhe Klinika Infektive

Organizatat Joqeveritare: Labirinti, CSGD, KOPF
ofrojnë këshillim dhe informim falas